



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-16257 të datës 31.03.2026, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-011/01-16254 të datës 31.03.2026, të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.06.2026 merr vendim për shpalljen e:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME KOMUNALE - LOKALET AFARISTE**

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, që të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale:

- I. Pronat e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim gjenden:** në zonën kadastrale Gjakovë Qytet, të evidentuara me numrat e ngastrave si në tabelën e më poshtme:

Nr.	Adresa/Rr.	Njësia	Sipërfaqja	Çmimi fillestar mujor në m ²
1.	Nëna Tereza	1003-0-23-1-5-0	61 m ²	890€
2.	Mbretëresha Teuta	3307-0-34-2-3-0	40 m ²	600€
3.	Mbretëresha Teuta	1125-1-30-1-1-0	22 m ²	350€
4.	Mbretëresha Teuta	3307-0-34-2-2-0	52 m ²	400€
5.	Mbretëresha Teuta	34-2-1-0	53 m ²	420€
6.	Anton Çetta	5108-1-43-2-2-0	64 m ²	230€
7.	Anton Çetta	5109-1-42-2-1-0	54 m ²	160€
8.	Anton Çetta	5109-1-42-2-2-0	49 m ²	140€
9.	Anton Çetta	5109-1-42-3-4-0	49 m ²	140€
10.	Shefki Shasivari	1074-0	40 m ²	200€

II. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronave:

Afati për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në dhjetë (10) vite.

III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është:

- a) Funksionalizimi i Lokalit;
- b) Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies.

IV. Kushtet e veçanta:

Lokalet në numër rendor 1 deri 5 duhet të kenë këto kushte:

- a) Përzgjidhet oferta me çmimin më të lartë të ofruar në ankand;
- b) Aktiviteti kryesor i biznesit në tri (3) vitet paraprake, për lokalet në listë me numër rendor 1 deri 5 duhet të jetë në fushat të cilat nuk kanë ndikim në mjedis, prodhim në rend dhe veprimtari që ndikojnë në akustikë;
- c) Ofertuesit duhet të kenë të punësuar së paku tre (3) punëtorë përveç pronarit;
- d) Qarkullimi financiar për tri (3) vitet paraprake duhet të jetë 150.000€;
- e) Në rast se në ankand ofrohen dy apo më tepër çmime më të larta dhe të njëjta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertave, në prani të tyre dhe të Komisionit Vlerësues.

Lokalet në numër rendor 5 deri 10 duhet të kenë këto kushte:

- a) Përzgjidhet oferta me çmimin më të lartë të ofruar në ankand;
- b) Në rast se në ankand ofrohen dy apo më tepër çmime më të larta dhe të njëjta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertave, në prani të tyre dhe të Komisionit Vlerësues.

V. Kushtet e përgjithshme të ankandit publik:

1. Ofertës duhet bashkangjitur këto dokumentacione për lokalet 1 deri 5:

- a) **Certifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me informacionet mbi biznesin;**
- b) **Vërtetimi i ATK-së mbi kryerjen e obligimeve tatimore;**
- c) **Vërtetimi i tatimit në pronë (të pronarit të biznesit dhe në emër të biznesit, që nuk ka detyrime të papaguara);**
- d) **Vërtetimi i Sektorit për Menaxhimin e Pronës Komunale që nuk kanë obligime të papaguara të shfrytëzimit të pronës komunale;**
- e) **Lista e punëtorëve për tri (3) vitet paraprake;**
- f) **Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pageses për Tatimin në të Ardhurat Korporatave për tri (3) vitet paraprake;**
- g) **Vërtetimi i taksës në firmë;**
- h) **Dokumenti që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, për përfaqësuesin e biznesit dhe pronarin e biznesit, jo më e vjetër se 6 muaj), si dhe**
- i) **Vërtetimi i gjykatës kompetente që Biznesi ekonomik nuk është në falimentim, ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor.**

2. Ofertës duhet bashkangjitur këto dokumentacione për lokalet 5 deri 10:

- a) **Certifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me informacionet mbi biznesin;**
- b) **Vërtetimi i ATK-së mbi kryerjen e obligimeve tatimore;**

- c) Vërtetimi i tatimit në pronë (të pronarit të biznesit dhe në emër të biznesit, që nuk ka detyrime të papaguara);
 - d) Vërtetimi i Sektorit për Menaxhimin e Pronës Komunale që nuk kanë obligime të papaguara të shfrytëzimit të pronës komunale;
 - e) Vërtetimi i taksës në firmë;
 - f) Dokumenti që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, për përfaqësuesin e biznesit dhe pronarin e biznesit, jo më e vjetër se 6 muaj), si dhe
 - g) Vërtetimi i gjykatës kompetente që operatori ekonomik nuk është në falimentim, ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor.
3. Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.
 4. **Vërejtje:** Më qëllim të gjithëpërfshirjes, në këtë Ankand mund të paraqitet vetëm një ofertë për një dyqan nga një ofertues. Në rast se një biznesi/ofertues aplikon në ankand për dy apo me shumë lokale, oferta e tyre diskualifikohet menjëherë.
 5. Shfrytëzimi i pronës mund të bëhet vetëm sipas destinimit të cilin e ka – lokal afarist.
 6. Komuna për interes të përgjithshëm në zbatim të projekteve në prona publike rezervon të drejtën të realizojë punime pa u penguar nga shfrytëzuesi.
 7. Shfrytëzuesit ka për obligim që të bëjë renovimin dhe rregullimin e lokale, me qëllim të funksionalizimit të tyre me miratimin e Komunës.
 8. Pagesat dhe obligimet e të gjitha komunalive në pronën komunale barten tek shfrytëzuesi nga koha e nënshkrimit të kontratës.
 9. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb – faqe të Komunës dhe në vendet publike. **Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimet, kati përdhësë, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë, nga data **19.06.2026** deri me datë **03.07.2026** në orën 15:00h dhe të protokollohen nga Komuna.
 10. **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Objekti i Komunës së Gjakovës, Rruga “UÇK” (ish objekti i Bankosit), kati I, salla nr. 8 Kabineti i Kryetarit, me datën **07.07.2026** nga ora 13:00, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.
 11. **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:** Të informohen me procedurat e ankandit publik, të shohin pronën që jepet në shfrytëzim, të kenë qasje në dokumentacionet e pronës dhe të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
 12. Procedurat e ankandit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.

13. **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës** Komisioni Vlerësues brenda tre (3) ditë pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave. Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha çmimet e ofertuesve. Pas vlerësimit të ofertave në ankand publik, Komisioni vlerësues harton raportin përfundimtar dhe për zgjedh ofertën fituese. Pas miratimit të ofertës së për zgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi për ofertën e për zgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike si dhe në ueb-faqen zyrtare të komunës.
14. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.
15. Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.



Gani Hajdari

Kryesues i Komisionit Vlerësues